

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Ardian Ajvazi dhe procesmbajtësen Minire Krasniqi, në çështjen juridike, sipas padisë së paditëses [REDACTED], dega në Shtime Rr. [REDACTED] të cilin me autorizim e përfaqëson [REDACTED] nga Ferizaj, e kundër të paditurve [REDACTED] dhe [REDACTED] nga Shtimja Rr. [REDACTED], baza e kontestit mospagimi i ëit nga kontrata mbi huanë, në seancën e mbajtur me datë 04.09.2015, në prezencën e të autorizuarit të paditësit dhe të paditurit të parë, merr këtë:

### A K T G J Y K I M

APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses [REDACTED], dega në Shtime Rr. [REDACTED] DETYROHEN të paditurit [REDACTED] dhe [REDACTED] nga Shtimja Rr. [REDACTED], që paditëses t'ia kompenzojë shumën prej 1,035.00 Euro (njëmijë e trëdhjetë e pesë Euro) së bashku me kamatën, e cila do të llogaritet sipas lartësisë që llogarisin bankat për deponimet e rëndomta të qytetareve, të afatizuara për periudhë një vjeqare pa destinim të caktuar, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij Aktgjykimi e nën kërkcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

### A r s y e t i m i

Gjykata për këtë çështje juridike civile ka caktuar seancën për shqyrtimin përgaditor të çështjes, mirëpo për shkak të pandërlikueshmërisë së çështjes, nga seanca përgaditore ka kaluar menjëherë në atë kryesorën. Kjo mundësi parashihet edhe në nenin 420.3 të Ligjit të Procedurës Kontestimore “Gjykata mund të vendosë që seanca për shqyrtim kryesor të çështjes të mbahet menjëherë pas asaj përgaditore”.

Paditësi përmes të autorizuarit të tij ka parashtruar padi në këtë Gjykatë më datë 19.04.2013. Paditësi me padi dhe seancën e datës 04.09.2015 ka theksuar se me datën 10.11.2010, i padituri dhe bashkëhuamarrësi i tij (e paditura e dytë) kanë nënshkruar kontratën e kredisë nr.KOFE-979-003 me paditësin [REDAKTUAR] dega në Shtime në shumën prej 1,000 Euro, e cila si e till duhet të paguhet për 24 muaj në këste mujore, duke përfshirë edhe shkallën e interesit vjetor prej 29.03%. Paditësja përmes përfaqësuesit të saj ka kërkuar që padia dhe kërkesa e saj të aprovohet në tërësi si e bazuar.

I padituri [REDAKTUAR] në fjalën hyrëse dhe atë përfundimtare në seancën e datës 04.09.2015 ka theksuar se është e vërtetë se tek paditësja [REDAKTUAR] me datë 10.12.2010 ka marrë kredi në shumën prej 1,000 Euro, me afat të kthimit për 24 muaj, po ashtu theksoi se katër këste ia ka pagur paditëses në shumën prej 217 Euro. Për shkak të gjendje ekonomike nuk ka mundur ta bëjë pagesën e ratave sipas marrëveshjes së nënshkruar në mes tij dhe KEP. Nëse i vjen mundësia financiare theksoi se do ta paguan në tërësi borxhin.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes së fakteve të çështjes, për aq sa palët ndërgjygjëse përmbushin detyrimin e tyre për t'i parashtruar ato, në kuptim të nenit 7.1 të LPK-së, Gjykata ka administruar një sër provash.

- Kontratën për kredinë e lidhur me datë 10.11.2010 në mes kredidhënësit [REDAKTUAR] dhe bashkëkredimarrësve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] tani të paditur në këtë procedurë, me të cilën kontratë vërtetohet fakti se ndërmjet palëve ndërgjygjëse ka ekzistuar një marrëdhënje kontraktore për kredidhënje përkatësisht kredimarrje;
- Shtojca numër 1, me të cilën vërtetohet fakti se të paditurit kanë qenë të detyruar që ta kthejnë kredinë e marrë duke ju përmbajtur këtij orari dhe atë duke filluar nga data 10.12.2010 e deri në pagesën definitive me datë 12.11.2012;
- Vërejtja para padisë, me të cilën [REDAKTUAR] ka kërkuar nga i padituri [REDAKTUAR] ta përmbush detyrimin nga kontrata e kredisë, në të kundërtën do të inicon procedurë gjyqësore;
- Lëternjoftimi i bashkëhuamarrëses [REDAKTUAR];

-Orari i kredisë, me të cilën po ashtu vërtetohet fakti për arritjen e detyrimit për pagesë dhe kohën e përmbushjes së tij;

-Orari i ripagesave të kredisë, me të cilën vërtetohet fakti se i padituri [REDAKTUAR] ka paguar paditëses katër rata në shumë prej 271 Euro, ndërsa borxhi i marrë është 1,000.00 Euro së bashku me kamatën vjetore prej 29.03% për 24 muaj, nga kjo shihet se i padituri i ka mbetur borxh të paditurit edhe 1,035.00 Euro.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve dhe provave të lartë cekura, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se padia e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Pas vlerësimit dhe administrimit të provave dhe pohimeve të palëve ndërgjygjëse Gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

*-Se të paditurit [REDAKTUAR] kredimarrës dhe [REDAKTUAR] si bashkëkredimarrëse kanë marrë kredi në [REDAKTUAR] me në shumën prej 1,000 Euro me afat të kthimit prej 24 muajve duke filluar nga data 10.12.2010 e deri me datë 12.11.2012;*

*-Se të paditurit e kanë përmbushur një pjesë të kredisë së tyre dhe atë katër kështe në shumën prej 271 Euro, kjo shihet edhe përmes orarit të ripagesave;*

*-Se ekziston baza juridike për përgjegjësi e të paditurëve për kthimin e ëit në shumën prej 1,035.00 Euro, në bazë të kontratës për kreditë e lidhur me datë 10.11.2010 në mes kredidhënësit [REDAKTUAR] dhe bashkëkredimarrësve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR].*

Nga faktet e treguara në padinë e paditësit si dhe nga provat dhe shkresat që gjenden në lëndë, rezulton si e themelt tërësisht kërkesëpadia, se gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë kundërshti në mes provave të propozuara dhe fakteve të parashtruara nga paditësi. Gjykata vërtetoi se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për të vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Në anën tjetër paditësi i ka ofruar gjykatës prova të mjaftueshme për ta aprovuar pjesërisht padinë dhe kërkesën e saj, duke filluar nga provat materiale të shtjelluara në këtë



procedurë, deklarimeve të palëve ndërgjygjëse, në të cilat shihet kuart se paditësja e ka të bazuar shumën e aprovuar.

Pjesëmarrësit janë të detyruar që në raportet detyrimore të sillen në harmoni me tregun dhe politikën e përcaktuar ekonomike, që të mos e destabilizojnë tregun dhe të mos u sjellin dëm pjesëmarrësve të tjerë, klientëve. Punët e kryera në kundërshtim me parimet e marrëdhënieve të detyrimeve mund të shpallet nuliteti i tyre. Parimi i ndershmërisë dhe i ndërgjegjshmërisë janë dy parime kryesore në të drejtën e detyrimeve dhe palët ndërgjygjëse duhet t'ju përmbahen duke krijuar raporte juridike me mirëbesim. Në nenin 12 të Ligjit mbi Marrëdhënjet Detyrimore parashihet "Ne themelimin e marrëdhënieve të detyrimeve dhe në realizimin e të drejtave dhe detyrimeve nga këto marrëdhënie, pjesëmarrësit kanë për detyrë t'i përmbahen parimit të ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë". Gjykata nuk ka mundur të merr si të mirëqen faktin se në rastin konkret i padituri duhet paditëses ti paguaj edhe kamatvonesën në shumë prej 226.00 Euro, për shkak se konsideron se pala paditëse e ka shfrytëzuar pozitën e palakmueshme ekonomike të të paditurit dhe gjendjen e vështir, mendje lehtësinë dhe pozitën e varësisë.

Andaj Gjykata duke u bazuar në nenin 143 të Ligjit të procedurës Kontestimore (LPK), neneve 557 dhe 562 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore (LMD 1978) ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

### GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.190/12, me datë 04.09.2015



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të kopjes së tij, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e të dorëzohet përmes kësaj Gjykate. Afati fillon nga dita e nesërme nga pranimit i këtij Aktgjykimi.

